

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pas 23 vitesh - Madonna rikthehet në MTV VMA, nga puthja me Britney Spears te skena që e bëri mbret ëreshë të popit
ADRESA	https://kohajone.com/showbiz/pas-23-vitesh-madonna-rikthehet-ne-mtv-vma-nga-puthja-me-britney-spears-te-skena-qe-e-beri-mbretereshe-te-popit/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 18:37:25 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 18:33:19 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	165f731fa2681a37e41ed8aaed8f6d01875291ef0d5bd6913108e816cd844365
TEKSTI	adb99aa2849b188ab27936d47928ef8d4389c1117e227d30aa9f614c89d4051c
PAMJA	400f1487404f4db9bb5f3bb14a83aab3231f4584bbd813d6a7ae617c7972be31

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	88476b10f27a6a2ee451312ac68d31674ba8e2e215e88fcf2ab105802b54912a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	67690963e34eac89a6c1ba46d066d36b47b728bdbf8bf8d029d400ef1ab927ee
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/88476b10f27a6a2ee451312ac68d31674ba8e2e215e88fcf2ab105802b54912a>


PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Pas 23 vitesh – Madonna rikthehet në MTV VMA, nga puthja me Britney Spears te skena që e bëri mbretëreshë të popit

AKTUALITET SHOWBIZ E DIËL, 27 SHTATOR 2026 20:33



23 vite pas performancës që u bë një nga momentet më të famshme në historinë e MTV Video Music Awards, Madonna rikthehet sonte në skenën e VMA-ve.

Por këtë herë rikthimi i saj nuk është thjesht nostalgji. "Mbretëresha e Popit" vjen si artistja me më së shumti nominime të mbrëmjes dhe do të hapë ceremoninë në Los Angeles.



Sonte, 27 shtator 2026, MTV Video Music Awards rikthehen në Los Angeles dhe një emër do të jetë në qendër të vëmendjes më shumë se çdo tjetër.

Ajo do të hapë ceremoninë me performancën e saj të parë live në VMA që prej vitit 2003, duke i dhënë fund një mungese prej 23 vitesh nga skena muzikore e ceremonisë.

MTV dhe CBS e kanë cilësuar rikthimin si një moment historik, ndërsa vetë historia e Madonnas me VMA-të e bën këtë paraqitje shumë më të madhe se një performancë e zakonshme.

Dhe ka një arsye tjetër pse sonte vëmendja është te ajo. Madonna nuk kthehet vetëm për të performuar.

Ajo hyn në këtë ceremoni me 11 nominime, përfshirë kategoritë kryesore si: "Videoja e vitit", "Artisti i vitit" dhe "Kënga e Vitit".

Është hera e tretë në karrierë që ajo kryeson listën e nominimeve të VMA-ve.

Më parë kishte marrë nga nëntë nominime në vitin 1990 për "Vogue" dhe në vitin 1998 për projektet "Ray of Light" dhe "Frozen".

Gjithçka nisi në vitin 1984

Për ta kuptuar rëndësinë e rikthimit të sotëm, duhet kthyer pas më shumë se katër dekadash.

Madonna ishte vetëm 26 vjeçe kur u ngjiti në skenën e ceremonisë së parë të MTV VMA-ve, në vitin 1984.

LAJMET KRYESORE



Mesazh urgjent i kryeministrit Rama sapo mbërriti nga SHBA (fjala e plotë)



A do të shkojë ambasadori Wendt në Selinë Blu për të takuar Berishën?



Shqipëria fiton me dy gola ndaj Bjellorusisë



Mirë se vjen, Ambasador Wendt!



Presidenti Begaj zbarchd takimin me ambasadorin e ri të SHBA, Eric Wendt

TË PËRZGJEDHURA



Singapori paguan qytetarët për të lexuar: 15 minuta në ditë në këmbim të parave



David Beckham merr 39 milionë paund dividend, marrëveshjet e Kupës së Botës nxisin fitime rekord



Ish-ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu te Nikoll Lesi: Nuk ka ministra hije! Balluku-lokomotivë shtetf...



Sukses i menjëhershëm për Muse të Metës: Mjeti i AI tejkalon rivalët si ChatGPT dhe Claude



Inteligjenca artificiale mund të jetë më e rrezikshme se bomba atomike. Robotët e vitëve 2030, 2040, 2...

MË TË LEXUARAT

Ajo interpretoi "Like a Virgin", e veshur me fustanin e bardhë të nusërisë, ndonëse performanca përfundoi duke u kthyer në një nga imazhet më të famshme të historisë së VMA-ve.

Në atë kohë, MTV ishte relativisht i ri dhe ceremonia po krijonte identitetin e saj. Madonna e kuptoi shumë shpejt se VMA-të nuk ishin thjesht një ceremoni çmimesh.

Ishin një skenë ku artistët mund të krijonin momente që publiku do t'i diskutonte edhe pas përfundimit të shfaqjes.

Dhe ajo e bëri këtë në mënyrë të përsëritur. Në vitin 1989 erdhi performanca e "Express Yourself", teksa në vitin 1990 interpretoi "Vogue".

Në vitin 1993 u rikthye me "Bye Bye Baby". Por asnjë prej këtyre paraqitjeve nuk do të mbetej aq shumë në kujtesën kolektive sa ajo e vitit 2003.

2003 – momenti që ndryshoi gjithçka

Në vitin 2003, Madonna u ngjit në skenë së bashku me Britney Spears dhe Christina Aguilera.

Ishte një interpretim që përfundoi me një puthje mes Madonnas dhe Spears, gjersa më pas edhe Aguilera u përfshi në momentin që menjëherë u bë lajm në mbarë botën.

Sot, 23 vite më vonë, performancë vazhdon të jetë një nga momentet më të lidhura me historinë e VMA-ve.

Pikërisht ajo ishte edhe paraqitja e fundit e Madonnas si performuese në këtë ceremoni.

Producenti i atëhershëm i MTV-së, Van Toffler, i cili ishte pjesë e krijimit të atij momenti, është rikthyer këtë vit në organizimin e VMA-ve dhe ka folur për dëshirën për të rikthyer atë atmosferë të paparashikueshme dhe spektakolare që lidhej me ceremoninë.

Por pse Madonna nuk u kthye më në skenën e VMA-ve?

Këtu historia bëhet më interesante.

Përgjigjja e shkurtër është se nuk ka një arsye të vetme, zyrtare, të deklaruar nga Madonna që shpjegon mungesën e saj 23-vjeçare.

Ajo që dihet është se pas vitit 2003, karriera e saj vazhdoi të ishte jashtëzakonisht aktive.

Madonna publikoi albume të reja, zhvilloi turne botërore dhe vazhdoi të shfaqej në evente të mëdha, por VMA-të nuk ishin më një pjesë e rregullt e ciklit të saj promovues.

Rolling Stone e përshkruan këtë si një lloj 'pauze të zgjatur' nga VMA-të.

Madonna pati disa paraqitje të veçuara në ceremoni përfshirë një dedikim për Michael Jackson në vitin 2009 dhe një paraqitje me Maluman në vitin 2018, por jo një performancë muzikore.

Në vitin 2021 u shfaq sërish në ceremoni, por pa u rikthyer si performuese në skenën muzikore. Pra, nuk ishte zhdukur nga bota e muzikës dhe as nga VMA-të në kuptimin absolut.

Ajo thjesht nuk kishte më një prani të rregullt performuese në këtë ceremoni.

Dhe kjo është një dallim i rëndësishëm.

Madonna vazhdoi të ndryshonte, edhe pse VMA-të ndryshuan bashkë me të. Pas vitit 2003, Madonna kaloi nëpër disa etapa të ndryshme artistike.

Publikoi albume si "Confessions on a Dance Floor", "Hard Candy", "MDNA", "Rebel Heart" dhe "Madame X", vazhdoi të ndërtonte turne madhështore dhe të eksperimentonte me muzikën, performancën dhe imazhin e saj.

Në vitin 2008 u bë pjesë e 'Rock & Roll Hall of Fame', e gjatë dekadave vazhdoi të mbetet një prej artisteve më të rëndësishme dhe më të shitura në historinë e muzikës pop.

Kjo do të thotë se mungesa e saj nga performanca e VMA-ve nuk duhet interpretuar automatikisht si mungesë aktiviteti.

Përkundrazi, karriera e Madonnas gjatë këtyre 23 viteve ka qenë një seri rikrijimesh.

Edhe shëndeti e ndryshoi ritmin e saj

Një tjetër moment i rëndësishëm erdhi në vitin 2023.

Në qershor të atij viti, Madonna u shtrua në kujdesin intensiv pasi zhvilloi një infeksion të rëndë bakterial.

Për pasojë, turneu i saj "Celebration Tour" u shty dhe planet e saj profesionale u ndërprejnë përkohësisht.

Menaxheri i saj, Guy Oseary, njoftoi në atë kohë se Madonna po rikuperohej dhe se angazhimet do të viheshin në pauzë.

Kjo periudhë ishte një tjetër dëshmi se karriera e saj nuk ka qenë një vijë e drejtë.

Ka pasur periudha të ekspozimit maksimal, pauza, transformime artistike dhe rikthime.

Dhe sonte është një tjetër rikthim.

Nga “Like a Virgin” te Madonna e vitit 2026

Nëse performanca e vitit 1984 simbolizonte lindjen e një ikone të re të popit, kurse ajo e vitit 2003 përfaqësonte një prej momenteve më provokuese të kulturës pop, paraqitja e vitit 2026 vjen me një tjetër kuptim.

Madonna nuk ka nevojë të prezantohet më.

Ajo është 68 vjeçe dhe rikthehet në një skenë ku dikur ishte një nga figurat që ndihmoi në përcaktimin e vetë identitetit të ceremonisë.

Sipas materialeve zyrtare të VMA-ve, rikthimi vjen në një moment të ri artistik për të, pas publikimit të albumit “Confessions II”, i cili është paraqitur si albumi i saj i ri në këtë cikël të karrierës.

Në këtë kuptim, performanca e sonte nuk është vetëm një kthim në të kaluarën.

Është edhe një mënyrë për të lidhur disa gjenerata të popit në të njëjtën skenë.

23 vite më vonë, çfarë e bën kaq të rëndësishëm këtë rikthim?

Sepse VMA-të dhe Madonna kanë një histori të përbashkët.Në shumë raste, Madonna nuk ishte thjesht një artiste që performonte në VMA.

Ajo ishte pjesë e arsyeve pse ceremonia u bë ajo që është.

Nga fustani i nusërisë në vitin 1984, te “Vogue”, nga provokimet e viteve ’90 deri te performanca me Britney Spears dhe Christina Aguilera në vitin 2003, paraqitet e saj janë kthyer në referenca të kulturës pop.

Edhe vetë organizatorët e VMA-ve e kanë përdorur këtë histori për ta ndërtuar narrativen e rikthimit të saj.

Paramount e përshkruan performancën e parë në vitin 1984 si një nga imazhet përcaktuese të historisë së ceremonisë dhe rikthimin e vitit 2026 si një moment ku historia “mbyll një rreth”.

Sonte, Madonna nuk po kthehet vetëm për nostalgji

Kjo është ndoshta pjesa më interesante e gjithë historisë.

Nëse do të ishte thjesht një rikthim nostalgjik, Madonna mund të shfaqej për disa minuta, të kujtonte të kaluarën dhe të largohej.

Por ajo hyn në ceremoninë e vitit 2026 me 11 nominime, përfshirë kategoritë kryesore, dhe do të jetë artistja që hap shfaqjen.

Kjo e vendos atë përsëri në qendër të një prej netëve më të mëdha të muzikës pop.

Dhe ndoshta pikërisht këtu qëndron simbolika më e madhe.23 vite më parë Madonna ishte ajo që krijonte momentin.

Sonte ajo rikthehet në të njëjtën skenë në një epokë kur interneti, rrjetet sociale dhe kultura e ‘viralitetit’ kanë ndryshuar mënyrën se si krijohet një moment i tillë.

Ajo që mbetet për t’u parë është nëse performanca e saj do të bëhet sërish një nga ato momente që publiku do t’i kujtojë vite më vonë.

Por një gjë është tashmë e sigurt: VMA-të e vitit 2026 po e hapin derën për të njëjtën artiste që, në vitin 1984, ndihmoi ta kthente këtë ceremoni në një spektakël të kulturës pop.

Dhe pas 23 vitesh, Madonna po kthehet pikërisht aty ku historia e saj me MTV-në kishte mbetur pezull.

Nga Egzona Shigjeqi /Telegrafi/

MË SHUMË NGA AKTUALITETI

Tragjedi në Fier, 70-vjeçari humb jetën në banesën e përfshirë nga fl...

“Mua tani më pret dorëheqja, por lufta sapo ka filluar”, Vuçiç përkul...

Stuhia godet Nju Jorkun dhe Nju Xhersin, bilanciçet flasin për një të v...

“Patëm një dasmë të madhe shqiptare, po na rritet rrethi”, Dua Lipa s...

Papa Leo XIV i bën thirrje Kishës franceze të vazhdojë luftën kundër ...

Aktivisti Arben Kola ditën e 120-të të protestës, ka hedhur akuza të ...

LAJMET E FUNDIT

Ministri Ferit Hoxha avancon me rokadën e ambasadorëve, Denion Meidani shkon në Prishtinë, Petrit Malaj në Shkup

[12 MINUTA MË PARË](#)

Tragjedi në Fier, 70-vjeçari humb jetën në banesën e përfshirë nga flakët

[17 MINUTA MË PARË](#)

“Mua tani më pret dorëheqja, por lufta sapo ka filluar”, Vuçiç përkulet para popullit: Nuk kemi lindur në koltuk!

[20 MINUTA MË PARË](#)

Stuhia godet Nju Jorkun dhe Nju Xhersin, bilancet flasin për një të vdekur, ndërprerje të energjisë dhe fluturimeve, ...

[31 MINUTA MË PARË](#)

“Patëm një dasmë të madhe shqiptare, po na rritet rrethi”, Dua Lipa sjell pamje nga dasma e familjes në Kosovë

[36 MINUTA MË PARË](#)

Papa Leo XIV i bën thirrje Kishës franceze të vazhdojë luftën kundër abuzimit seksual

[48 MINUTA MË PARË](#)

MË SHUMË LAJME TË FUNDIT >

Gazeta "KOHA JONË" themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991
Botues: Nikoll LESI. Adresa e redaksisë: Rruga "Samë Frasheri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

TË FUNDIT

LAJME

SPORTI

EKONOMI

EDITORIAL

WEBTV

AKTUALITET

RAJONI

KOSOVA

BOTA

TEKNOLOGJI

SHOWBIZ

SHËNDETI

SOCIALE

TURIZËM

KURIOZITETE

KULTURA

HISTORIKU

KONTAKT

BOTUES & DREJTOR: Nikoll LESI

KRYEREDAKTOR: Daniel MUÇAKU

ZV/KRYEREDAKTOR: Redjon SHYVLLA

BORDI: Elsa KAMBERI, KRYETARE

NIPT: J71425013C



NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA

